

MARENGLLEN VERLI**RRYMAT POLITIKE BRENDA KOMITETIT “MKK”
DHE POZICIONI I HOXHA KADRI PRISHTINË***

Komiteti “MKK” (1918-1924) është cilësuar nga autorë të ndryshëm si qeveria e Kosovës në mërgim, truri i organizatave kombëtare shqiptare etj., për periudhën e viteve të para pas Luftës së Parë Botërore.

Edhe pse deri sot ndër studiuesit nuk ka dilema për kontributin e kësaj organizate në mbrojtjen e të drejtave të popullsisë shqiptare në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, duke e përfaqësuar denjësisht atë, si edhe në zhvillimet e brendshme politike në Shqipëri që ndikuan në konsolidimin dhe demokratizimin e shtetit shqiptar, pak është studiuar përtej vështrimit global për të evidentuar rrymat e ndryshme politike brenda Komitetit “MKK”, të shfaqura dukshëm veçanërisht që nga viti 1920, si edhe individët që i përfaqësonin ato¹.

Natyrisht, kjo nuk është një ndërmarrje e thjeshtë, kërkon gjurmime të mëtejshme në arkiva, përfshirë edhe ato të huaja, për të zbuluar pikëpamje e veprime të diferencuara të rretheve politike e individëve, ndryshimin e qëndrimeve dhe pikëpamjeve të tyre në situata të ndryshme, grupimet e rigrupimet e individëve dhe orientimet e riorientimet e tyre e të organizatave apo partive ku bënë pjesë në përshtatje me koniunkturat jo statike të brendshme e ndërkombëtare.

Përbërja e Komitetit “MKK” në vitet 1918-1920, jo vetëm me përfaqësues të shqiptarëve të Kosovës ose të viseve të tjera shqiptare jashtë kufijve që ju njohën shtetit shqiptar, ndonëse këta ishin më të shumtit, por edhe nga shqiptarë të viseve të “Shqipërisë Londineze”, ishte një fakt që nuk lidhej thjesht me situatën e veçantë politike të Shkodrës,

* Kumtesë mbajtur në simpoziumin shkencor organizuar nga Instituti i Historisë – Prishtinë me temë: *Veprimtaria politike e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”*, Prishtinë, 30 nëntor 2010.

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2007, f. 458-461; *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* (më tej: *FESH*), vëll. II, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: “Kristalina KH”, 2009, f. 1234; Lush Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924*, Prishtinë: 1997; *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”* (Përmbledhje kumtesash), Tiranë: 2004, f. 16, 32, 51, 86, 109; etj.

qytetit ku u krijua dhe pati qendrën e vet Komiteti “MKK”, si edhe me praninë atje të atdhetarëve nga pothuaj të gjithë trevat shqiptare në vitet 1914-1915 dhe 1918. Komiteti “MKK”, fillesat e para të të cilit ndoshta duhet t’i kërkojmë qysh në vitet 1914-1915*, ishte në fakt grupimi i ri i përfaqësuesve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të riformatuar pas 1912-ës. Ky “Krah Kombëtar”, siç e quante Sejfi Vllamasi², synonte t’i jepte zgjidhjen e duhur çështjes shqiptare të gjendur në një udhëkryq problematik pas viteve të vështira 1913-1918, në konstelacionin e koniunkturave të reja ndërkombëtare. Dihet që ato ishin aso kohe aspak të favorshme dhe të molepsura nga fryma e pazareve mes aleatëve fitimtarë të vegjël ose të mëdhenj, që tashmë po kërkonin haptazi shpërblimet e rastit, për të cilat ishin marrë vesh fshehtazi në Londër më 1915, sikurse dëshmonte edhe Traktati i Fshehtë³.

Elita politike shqiptare e dekadave të fundit të sundimit osman kishte qenë e diferencuar në dy grupime të dallueshme. Atdhetarët, të moderuar apo radikale, kishin punuar për emancipimin e gjithanshëm të kombit dhe njësimin politiko-administrativ të viseve shqiptare, ndërkohë që grupimi otomanist identifikonte veten me regjimin sulltanor. Ngjarjet

* Gjatë periudhës shtator 1914-1915 në Shkodër ndodheshin Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Aqif Pasha, Sotir Peci, Luigj Gurakuqi, Fejzi Alizoti, Eshref Frashëri, Muço Qulli, Çerçiz Topulli, Koço Kota, Kristo Floqi, Sejfi Vllamasi etj.

Në 14 shkurt 1915, konsulli i përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Halla, i shkruante ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, baronit Stefan Burianit: “Është formuar këtu një komitet nën drejtimin e Kadri Prishtinës, i njohur edhe atje. Ai m’u lut për sigurimin e një shume rreth 600 napolona ari për blerjen e municionit” për një kryengritje në Kosovë. Në një relacion të datës 27 prill i njejtë konsull paraqet një listë me emra të kosovarëve të njohur të vendosur në Shkodër që duheshin ndihmuar financiarisht. Midis tyre figuronin Kadri Prishtina, Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri etj. (Shih më gjerë Kahreman Ulqini, “Shkodra dhe Komiteti “MKK””, në vëllimin *Komiteti “MKK”* (Përmbledhje kumtesash), Tiranë: 2004, f. 105. Shih edhe Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri*, Tiranë: “Neraida”, 2000, f. 135-137; Tafil Boletini, *Pranë Isa Boletinit 1892-1916* (Kujtime), ALBUM, vëll. I, Tiranë: 1996, f. 190-197, etj.

² S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 113.

³ *Historia e Popullit ...*, vëll. III, f. 78, 129-139; Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: “Toena”, 2009, f. 167-187, etj.; shih edhe Zamir Shtylla, “Rreth krijimit dhe veprimtarisë së Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1986.

që ndërthurën Krizën Lindore, Kongresin e Berlinit dhe Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, i kishin evidentuar aso kohe grupimet dhe individët që përfaqësonin këto grupime⁴. Por ngjarjet e mëdha transformuese që pasuan Revolucionin Xhonturk dhe shpalljen e Kushtetutës apo Hyrietit në Perandorinë Osmane, e kishin mjegulluar disi tablonë e elitës politike shqiptare. Aleatët dhe kundërshtarët e vjetër të pushtetit qendror në Stamboll nuk ishin doemos të njëjtit edhe ndaj pushtetit të ri të xhonturqve.

Turbullirën apo vështirësinë e përcaktimit të orientimit politik të individëve, madje grupimeve të ndryshme, e shtoi periudha pas viteve 1912-1913. Përfshirja e fqinjëve agresivë ndër fitimtarët e Luftës Botërore, shembja dhe shpërbërja e aleates së madhe kryesore të shqiptarëve, Perandorisë Habsburge më 1918, rreshtimi i ish aleates tjetër të madhe, Italisë ndër ata që kërkonin asgjësimin e shtetit shqiptar, përgjithësisht mungesa e principeve të drejtësisë të fuqive që do të kishin në dorë të vendosnin të ardhmen e Europës së pasluftës, madje të Botës, e kish shkërmoqur e grimcuar keqas elitën politike shqiptare⁵. Shumë personalitete të periudhës së mëparshme ndodheshin tashmë larg Shqipërisë dhe nuk do të ktheheshin më kurrë. Të tjerë, veçanërisht ata nga trevat shqiptare të aneksuara nga shtetet fqinje, ishin shpërngulur nga viset e origjinës ose nga vendbanimet e mëparshme dhe do t'u duhej kohë që të ristabilizoheshin e integroheshin në ambientin e ri. Kurse disa të tjerëve rrethanat e jashtëzakonshme të viteve 1912-1918 u kishin shkaktuar ndryshime në orientimin politik⁶.

Në situatën e re të fundluftës së Parë Botërore po përvijohesh së pari ideja se duhej lëvizur politikisht drejt Antantës fitimtare. Komiteti

⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.II, Tiranë: "Toena", 2002, f. 150, 188, 197, 204, 289, 293, 484; Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)*, Tiranë: 1997; *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe vendi i saj në histori* (Materiale nga Konferenca Shkencore kushtuar 125-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, mbajtur më 9-10 qershor 2003 në Prizren), Prishtinë: 2008, etj.

⁵ Marenglen Verli, *Shqipëria dhe Kosova – historia e një asperate*, Tiranë: "BOTIMPEX", 2008; *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920* (Përmbledhje dokumentesh), vëll.I, II, Tiranë: Akademia e Shkencave, 1975, 1976; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 153, 158, 173, 177, 181, 182, 184, 190, etj.; A. Puto, *Shqipëria politike ...*, f. 187, 217, 245, 283.

⁶ *Po aty*; shih edhe Lef Nosi, *Dokumente historike 1912-1924*, Tiranë: Shtypshkronja "Nënë Tereza", 2007, etj.

“MKK” i krijuar më 1 maj 1918, me sa duket në bllok e përqafoi këtë ide⁷. Zhvillimi i ngjarjeve në Kosovë gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1918, sikurse dëshmojnë të dhënat që njohim, tregon se personalitetet politike të Kosovës dhe me sa duket edhe të tjerë nga viset e ndryshme të Shqipërisë, të afërt me ta, kuptuan dhe vlerësuan drejt situatën. Azem Galica në emër të lëvizjes kryengritëse shqiptare hyri në bashkëpunim me rezistencën serbe të drejtuar në terren nga Kosta Peçanci dhe bashkarisht në vjeshtë të vitit 1918 ndërmorën aksione për dëbimin e forcave të armatosura bullgare e austro-hungareze nga viset respektive të okupimit, me ç’rast kapën robër, i çarmatosën dhe ua dorëzuan trupave franceze të frontit të Selanikut, që depërtuan në Kosovë në javët e fundit të Luftës Botërore⁸.

Ndërkohë, menjëherë pas luftës në elitën politike shqiptare u krijuan dy lobe, jo aq konsekuente e mjaft fluide, por sidoqoftë disi të konturuar. Lobi proitalian që dominoi Kongresin e Durrësit në dhjetor 1918, siç duket mbështeti idenë për një protektorat italian mbi Shqipërinë*. Kurse lobi tjetër, këmbëngulte për një Shqipëri të pavarur**, duke shpresuar në manovrimin midis interesave dhe kontradiktave në kuadrin e shteteve ballkanike. Ai dominoi në Kongresin e Lushnjës, në janar të vitit 1920 dhe realizoi Luftën e Vlorës po atë vit⁹. Kjo rrymë kishte brenda dhe Federatën Panshqiptare “Vatra”, që për të siguruar pavarësinë kërkonte mbështetjen e SHBA dhe zbatimin e programit prej 14 pikash të presidentit Uilson. Brenda kësaj rryme evidentoheshin

⁷ Z. Shtylla, “Rreth krijimit ...”; Marenglen Verli, *Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: “BOTIMPEX”, 2008, f. 75, 117, 190.

⁸ Po aty; shih edhe Limon Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928*; Prishtinë: 1981, f. 28; Limon Rushiti, *Rrethanat shoqërore politike në Kosovë 1912-1918*, Prishtinë: 1986, f. 250; Tahir Abdyl, *Hasan Prishtina*, Prishtinë: “Rilindja”, 1991, f. 209.

* Përfaqësues të këtij lobi ishin Turhan pashë Përmeti, Myfid bej Libohova, Syrja bej Vlora, Mustafa Kruja, Hasan bej Prishtina, Fejzi bej Alizoti, Preng Bib Doda, etj.

** Përfaqësues të këtij lobi ishin Mehmet Konica, Aqif pashë Elbasani, Mihal Turtulli, Eshref Frashëri, Iljaz bej Vrioni, Ramiz Daci, Xhaferr Ypi, Adem Gjinishi, Sali Çeka. Kostaq Kita, Sali Butka, Hoxha Kadri Prishtina, Sejfi Vllamasi, Rexhep Shala, Qazim Kokoshi, Sotir Peci etj.

⁹ *Historia e Popullit ...*, vëll.III, f. 123, 126, 139, 165; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike ...*, f. 158, 182, 190; A. Puto, *Shqipëria politike ...*, f. 187, 245; M.Verli, *Shqipëria dhe Kosova ...*, f. 226, 231.

demokratët popullorë me prirje radikale, të prirur për përdorimin e çdo mjete, përfshi edhe veprimet e armatosura, për të siguruar pavarësinë e vendit. Natyrisht të dy lobet kishin këndvështrime të ndryshme për përcaktimin se nga i vinte Shqipërisë rreziku më i madh. Ishte ndjesi normale që për shumë politikanë kosovarë alergjia ndaj Serbisë, e kthyer tani në një shtet të madh me emrin Shteti serbo-kroato-sllloven (përndryshe Jugosllavi), çonte në vlerësimin e Italisë si aleate¹⁰. Hoxha Kadriu, drejtuesi i MKK, ishte ndër ata që prirej të preferonte SHBA në rast të vendosjes së një tutele të huaj. Sipas tij dhe të atyre që ndanin të njëjtën pikëpamje me të, nëse Konferenca e Paqes e Parisit do të vendoste për ta futur Shqipërinë nën protektorat, SHBA për shkak të largësisë gjeografike, mosimplikimeve në të kaluarën me shtetet ballkanike në dëm të Shqipërisë dhe parimeve demokratike të deklaruara, ishin protektori i preferuar¹¹. Por dëshira apo motoja e Hoxha Kadriut dhe bashkë-mendimtarëve të tij ishte konfirmimi i një Shqipërie plotësisht të pavarur, që të përfshinte brenda kufijve të gjithë trevat etnikisht shqiptare.

Duke ekuilibruar ekstremet, përkatësisht radikalët si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Hysni Curri etj., (të cilët, për shkak të dëshirës për sigurimin e kufijve të natyrshëm të Shqipërisë, prireshin të cedonin në drejtim të statusit të saj dhe përzgjidhnin protektoratin, ose guxonin të planifikonin aventura konfrontimi ushtarak me fqinjët me rezultate krejtësisht të dyshimta), por edhe të moderuarit si Rexhep Mitrovica, Halim e Sadik Derhalla, Sali Hoxha Vuçiterni, ose bashkë-mendimtarë të tyre, të afërt me Komitetin, njëherazi organizatorët e partisë legale të Xhemijetit” në Jugosllavi, si Nexhip Draga (që ishin gati të integroheshin përkatësisht në jetën politike të Shqipërisë ose Jugosllavisë, duke hequr dorë nga përpjekjet për të mbajtur në rend të ditës çështjen e çlirimit të Kosovës), Hoxha Kadriu afroi pranë vetes Bedri Pejanin (sekretar i KMKK), Rakip Kajabegollin (nënkryetar i KMKK), Tafil Boletin, Ismail Haki Nikoçin, Jonuz Tafilin (sekretar personal), Sali Nivicën (drejtor i gazetës “Populli”, organ i KMKK), Ahmet Gashin, sekretar i degës së Komitetit në Elbasan etj., dhe i dha tonin përmes një grupimi centrist politikës zyrtare racionale e konstruktive të KMKK¹².

¹⁰ *Po aty.*

¹¹ *Po aty; Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës...”, f. 32, 51, 62, 150, 163; L. Culaj, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës..., etj.*

¹² *Po aty.*

Pas Kongresit të Lushnjes, gjatë vitit 1920 e më pas, për shkak të përfshirjes në jetën politike të Shqipërisë por edhe për arsyen e sipërpërmendur, shumë nga nismëtarët që promovuan legalizimin më 7 nëntor 1918 të Komitetit MKK në Shkodër, përkatësisht Bajram Fevziu, Sejfi Vllamasi apo Ali Shefqeti, do të largoheshin nga Komiteti “MKK” dhe nga Hoxha Kadriu¹³. Madje edhe Hoxhë Kadriut që nga kjo kohë shumë energji e kohë filloi t’i konsumonte pjesëmarrja në qeveri, ose në zhvillimet politike në Shqipëri.

Gjithsesi kishte qenë meritë e Hoxha Kadriut dhe e grupit me pikëpamje racionale rreth tij, që të dy programet e Komitetit më 1918 dhe 1920, kishin rezultuar në thelb të njëjtë*, që çështja e Kosovës ishte

¹³ L. Culaj, *Komiteti MKK...*, f. 23.

* Programi i 1 majit 1918:
Shqipni në 1.V.1918

Programi themeltar i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës

Nyje I. Me u përpjekë para fuqive të mëdha t’Antantës dhe me e kërkue bashkimin e krahinave të Kosovës (*Shkup, Kumanovë, Preshevë, Tetovë, Gostivar, Kaçanik, Ferizaj, Gjilan, Prishtinë, Vuçiternë, Mitrovicë, Novi Pazar, Rozhajë, Pejë, Plavë, Gusi, Gjakovë, Prizren*) në Shqipni të lirë e vetëurdhënuese.

Nyje II. Me protestue para Pushteteve të Mëdha t’Antantës kundër mizorinave të sllave ndër krahinat të KOSOVIËS deri në ditë të sodit e që mundën me u ba edhe mbas sodit.

Nyje III. Me zgjedhë e me çue një delegacion për me i mbrojtë me fitim pikat e sipërpërmendura para botës zyrtare e jashtëzyrtare.

Për Komitetin Mbrojtja Kombëtare e Kosovës

Sekretari Prof. Bedri Pejani

Zëvendësi i Kryetarit Hysni Curri

(*Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi (më tej: F.) 846, dosja (më tej: D.) 1, fl.1).

Programi i ri themeltar i K MKK

Programi i Komitetit Kombëtar të Kosovës dhe Dibrës më 30 gusht 1920

Nyje I. Me i dalë zot vetësundimit dhe tërësisë tokësore të Shqipnisë

Nyje II Me përdor çdo mjet për me i librue Kosovën e Dibrën e çdo vend ku flitet shqip e me i bashkue nën sundimin e Shqipërisë së lirë.

Nyje III Në politikën e brendshme, me iu ba krah përparimit e bashkimit kombëtar e në politikën e jashtme me përkrah politikën e atyre shteteve të mëdha që diftojnë miqësi me Shqipnie të lirë e me idealin e Komitetit i cili shkruhet në Nyjen I e II.

publikuar në mënyrë të institucionalizuar, të argumentuar e cilësore, pranë kancelarive kryesore evropiane në Konferencën e Paqes në Paris dhe kështu do të publikohej edhe pas vitit 1920 në forume të ndryshme ndërkombëtare¹⁴.

Ishte gjithashtu meritë e tij dhe bashkëpunëtorëve që mendonin si ai që qëndresa e kombinuar deri me armë në Kosovë e më gjerë u bë përgjithësisht e organizuar e ideuar dhe e dimensionuar në mënyrën më të mirë të mundshme për kohën, për t'i sjellë dobi pjesës së robëruar të kombit. Ishte meritë e tij dhe e shokëve të tij, mandej, që kur shteti shqiptar, i shpëtoi më të keqes, domethënë shpërbërjes, copëtimit të mëtejshëm apo likuidimit të arritjeve të vitit 1913 dhe hyri në rrugën e konsolidimit dhe demokratizimit, ndërsa faktori ndërkombëtar e arkivoi çështjen e Kosovës, ata u angazhuan me mish e me shpirt nga njëra anë për zhvillimin e Shqipërisë (duke kryer me sukses detyra të rëndësishme në shtetin shqiptar) dhe, nga ana tjetër, për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve të Kosovës e më gjerë dhe për ndalimin e politikës së spastrimit etnik në ato treva¹⁵.

Edhe pse ende nuk kemi në duar të dhëna të shumta nga dokumentacioni i kohës që do të na lejonin të konkludonim pa mëdyshje për rrymat politike brenda Komitetit “MKK”, përsëri konturimi i tyre pas vitit 1920 mund të bëhet dhe një pjesë e anëtarëve të tyre mund të evidentohen. Po kështu mund të përcaktohen pozicionet e tyre për problemet e ndryshme, që kishin të bënin me zhvillimet në Shqipëri dhe në Kosovë, dhe herë-herë edhe motivet që përcaktonin pozicionimet respektive.

Meqenëse drejtimit kryesor të veprimtarisë së Komitetit “MKK” në vitet 1920-1924 ishin përpjekjet për korrigjimin e vendimeve të padrejta të Konferencës së Londrës për kufijtë e Shqipërisë, për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve nën sundimin e huaj dhe për konsolidimin e

Vendim

Në mbledhje që u mbajt më 30.8.1920 u pranua programi themeltar i Komitetit prej tre nyjeve që gjenden në faqe të parë nga Hasan Prishtina, H. Kadri, Rakip Tafili, B. Vokshi, K. Mahmut Begolli.

(AQSH, F. 846, D. 9, fl. 12).

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ L. Culaj, *Komiteti MKK...*, f. 102, 112, 123; *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” ...*, f. 62, 109; Pal Doçi, *Hoxha Kadri Prishtina*, Tiranë: 2005, f. 34, 50, 77, 88, 124.

demokratizimin e shtetit të pavarur shqiptar, kuptohet se ndarja në rryma apo grupime brenda Komitetit erdhi nga pozicionimi lidhur me vlerësimin e këtyre detyrave dhe preferenca për mënyrën si duheshin realizuar ato.

Kur Lufta e Parë Botërore ende nuk kish përfunduar por fundi i saj po përvijohet qartë, Komiteti ilegal i Kosovës, që në fakt ishte një front kombëtar apo “krah kombëtar” i elitës politike shqiptare, shpalli me programin e 1 majit 1918, pozicionin në krahun e Antantës. Njëherësh ai përcaktoi kërkesën për bashkimin e gjithë viseve shqiptare me anën e përpjekjeve diplomatike. A besohet vërtet në gjykimin e drejtë të fitimtarëve, sikurse shtrohet në program, apo teksti përmbante një hap diplomatik të rëndomtë? Nuk mund të thuhet diçka me saktësi, aq më tepër se nuk mund të flitet me siguri se cilët ishin hartuesit e këtij programi. Por besohet se orientimi strategjik i programit të 1 majit ka qenë pikëpamja e Hoxha Kadriut, aso kohe rezident në Shkodër, e miratuar në mënyrë konsensuale, kurse shprehja e besimit në gjykimin e drejtë të fitimtarëve për çështjen shqiptare, një politiesë diplomatike¹⁶.

Ndërkohë ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme të konfirmuara për përbërjen e Komitetit pas legalizimit të tij më 7 nëntor 1918 nga autoriteti ndërkombëtar që qeveriste Shkodrën që nga data 6 nëntor, përkatësisht gjenerali francez Bardi de Fourtou. Sipas S. Vllamasit, Komiteti “MKK”, fillimisht përbëhet nga Bedri Pejani (sekretari i Komitetit), Sali Nivica, drejtor i gazetës “Populli”, Bajram Fevziu dhe ai vetë, kurse në krye kishte Hoxha Kadri Prishtinën. S. Vllamasi saktëson se “në raste të nevojshme si këshilltarë të Komitetit ishin Hamit Gjylbegu e Riza Dani, si edhe Hysni Curri dhe Qerim Begolli¹⁷. Që personat në fjalë ndodheshin në Shkodër në nëntor të vitit 1918, ndërkohë që Hasan Prishtina e Bajram Curri etj., ishin larguar në Austri para tërheqjes së njësisve të fundit ushtarake austro-hungareze e gjermane (këta duke mos qenë në Shkodër në 1 maj të vitit 1918, nuk duhet të kenë dhënë pëlqimin edhe për programin e 1 majit 1918), provohet edhe nga burime të tjera¹⁸. Madje Bedri Pejani, Hysni Curri e Qerim Begolli kishin mbërritur në Shkodër njëherësh duke i prirë rrugën batalionit gjurmues francez “Chasseur

¹⁶ L.Culaj, *Komiteti MKK...*, f. 28. Shih edhe *Komiteti MKK...*, f. 17, 51; *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll. III, Tiranë: “Kristalina KH”, 2009, f. 2097.

¹⁷ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 161.

¹⁸ *Po aty*, f. 156; T. Boletini, *Pranë Isa Boletinit ...*, f. 28 etj.

alpin”, që ishte dërguar me urgjencë nga Kosova për të ndalur sherrin midis forcave serbe, të cilat kishin hyrë të parat në qytet dhe forcave italiane, që duhej të merrnin Shkodrën¹⁹.

Duke u pozicionuar në krahun e fitimtarëve elita politike e emigracionit kosovar nga njëra anë nuk pranoi të qëndronte në Kosovë e të bashkëpunonte me autoritetet serbe, duke dëshmuar se nuk dakordohej me restaurimin e pushtetit serb në viset shqiptare të copëtuara më 1913, kurse nga ana tjetër filloi veprimtarinë për sensibilizimin e opinionit publik dhe të kancelarive të shteteve perëndimore, veçanërisht të Fuqive të Antantës, për çështjen e Kosovës dhe për nevojën e zgjidhjes së drejtë të saj. Njëherësh, angazhim i veçantë u tregua për mobilizimin e forcave të kombit, veçanërisht në trevat në robëri për të kundërshtuar me çdo mjet politikën zyrtare serbe të dhunës dhe spastrimit etnik për të luajtur rolin e duhur në çlirimin e tyre dhe bashkimin me Shqipërinë e pavarur²⁰.

Në rrjedhën e veprimtarisë për realizimin e synimeve të përmendura drejtuesit e Komitetit “MKK”, pas legalizimit të Komitetit më 7 nëntor 1918, krijuan degë të tij në Kosovë (Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Prishtinë, Shkup, Pejë, Rahovec, Vushtri, Gjilan), në Shqipëri (në Tiranë, Durrës, Elbasan, Dibër etj.), dhe në disa shtete të tjera. Të njohura janë degët në Gjenevë të Zvicrës dhe në Stamboll të Turqisë. Gazeta “Populli” nën drejtimin e Sali Nivicës e më pas Bedri Pejani, ndërkohë, u bë organi zëdhënës i politikës unike të Komitetit të viteve 1918-1920²¹.

Në vitet 1918-1920 në Komitetin “MKK” përveç figurave politike nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi, të aktivizuar në Shkodër, si Hoxha Kadri Prishtina, Hasan Prishtina, Bedri Pejani, Bajram Curri, Hysni Curri, Rakip Kajabegolli, Qerim Kajabegolli, Tafil Boletini apo të shquar në degët e Komitetit si Rexhep Mitrovica, Halim e Sadik Gostivari dhe Sali Hoxha Vuçiterni (Sali Gjuka) në degën e Durrësit, Qamil Bala e Ahmet Gashi në degën e Elbasanit, Beshir Vokshi, Qazim Bakalli, Ibrahim Gjakova, Niman Ferizi, Ibrahim Fehmiu në degën e Gjakovës, Hasan Feri, Ismail Haki Nikoçi etj., në degën e Plavë-Gucisë

¹⁹ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 155-156.

²⁰ Shih *Historia e Popullit...*, vëll. III, f. 458, 461; *FESH...*, vëll. II, f. 1234; L. Culaj, *Komiteti MKK...*, f. 34, 60, 65, 75, 99, 150.

²¹ *Po aty*; shih edhe P.Doçi, *Hoxha Kadri...*, f. 19, 34; *Komiteti MKK...*, f. 163.

etj., kishte anëtarë edhe nga viset e tjera të Shqipërisë, ndër të cilët më të njohurit ishin Sali Nivica, Sejfi Vllamasi, Hamit Gjylbegu, etj.²²

Duke analizuar qëndrimet e këtyre anëtarëve dhe veprimtarëve të Komitetit MKK në ngjarjet e vitit 1920 konstatohet se shumica e tyre ishin bartës të idesë së pavarësisë së plotë në organizimin e Shqipërisë së Pasluftës Botërore ose në rastin më të keq, të pranimi të një protektori të largët si SHBA dhe nuk i përkisnin lobit proitalian. Hoxha Kadriu, Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani, Beshir Vokshi, Halim Gostivari, Hadush Kastrati, Ibrahim Gjakova, Osman Tetova etj., në ngjarjet e mëdha kombëtare të kohës u orientuan në krahun e duhur. Ata jo vetëm u prononcuan por edhe u aktivizuan në të mirë të organizimit të Kongresit të Lushnjës dhe të vënies në jetë të vendimeve të tij.

Ndër delegatët e Kongresit figuronin bashkëpunëtorë e persona të afërt me Komitetin si Ramiz Daci, Xhaferr Ypi, Irfan Ohri, Aqif pashë Elbasani, Sali Çeka, Eshref Frashëri, Xhemal Prishtina, Hasan Batusha, Rexhep Shala etj.²³ Menjëherë pas Kongresit shumë prej emrave të njohur nga Kosova, anëtarë ose bashkëpunëtorë të Komitetit u vunë në shërbim të qeverisë Delvina, për vendosjen e rendit dhe për zbatimin e programit të saj kombëtar. Për këtë qëllim u angazhuan gjithashtu energjikisht Bajram Curri, Ramiz Dibra, Hasan Feri, Elez Isufi, Ramiz Daci, Ragip Begolli, Rexhep Shala, Adem Boletini etj.²⁴

Pas Kongresit të Lushnjës dhe fitores së Luftës së Vlorës*, kur pavarësia e plotë e Shqipërisë dhe tërësia e saj tokësore në kufijtë e 1913-ës në parim dukeshin të siguruara dhe kur gjatë korrikut dhe gushtit në Koplik dhe Peshkopi ishte tentuar të largoheshin përtej “kufijve strategjikë”, deri në kufijtë e 1913-ës, trupat jugosllave, më 30 gusht

²² Po aty; shih edhe Z. Shtylla, “Rreth krijimit...”, f. 97; Kristaq Prifti, Zamir Shtylla, “Komiteti MKK dhe veprimtaria e tij për çlirimin dhe unitetin kombëtar”, në: *Studime historike*, nr. 4, 1988, f. 137-150; *Komiteti MKK...*, f. 163-165.

²³ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 197.

²⁴ *Po aty*, f. 499.

* Protokollin e Tiranës midis Italisë dhe Shqipërisë u nënshkrua nga S. Delvina dhe Gaetano Manzoni më 2 gusht 1920. Sipas tij qeveria e Romës do të respektonte sovranitetin shqiptar mbi Vlorën dhe tërësinë tokësore të Shqipërisë. Ushtria italiane do të tërhiqej nga çdo vend përveç Sazanit. Tërheqja do të kryhej gjatë gushtit. Pavarësia dhe tërësia tokësore në kufijtë e 1913 ishte siguruar. (Shih *Historia e Popullit ...*, vëll. III, f. 165-166).

1920 Komiteti “MKK” miratoi një program të ri²⁵. Në parim ai nuk ndryshonte nga i pari i 1 majit 1918. Në të parashikohej sikurse më parë zgjidhja e dy detyrave kryesore, së pari “me i dalë zot vetësundimit e tanësies tokësore të Shqypnies” (neni 1) si edhe “përparimit e bashkimit kombëtar” (neni 3), dhe së dyti të realizohet “me çdo mjet” çlirimi i Kosovës, Dibrës “e çdo vendi ku flitej shqip” e bashkimi i tyre me “Shqipninë e lirë” (neni 2). Në nenin 3 përcaktohej edhe pozicionimi në politikën e jashtme përkrah atyre shteteve të mëdha që “diftohen në miqësi me Shqipninë e Lirë e me idealin e Komitetit” të përcaktuar në nenin 1 dhe 2.

Në gjirin e Komitetit në këtë kohë nga njëra anë u bënë përpjekje për të zgjeruar formalisht Komitetin edhe gjeografikisht, për ç’arsye Komiteti u quajt i Kosovës dhe i Dibrës, kurse nga ana tjetër të tre rrymat apo grupimet politike filluan të integrohen në strukturat partiake në vend, duke humbur mëvetësinë më të dallueshme nga periudha e mëparshme.

Në Partinë Popullore të drejtuar fillimisht nga Fan Noli, e ku kishte peshë të veçantë Ahmet Zogu dhe anëtarë e bashkëpunëtorë të dikurshëm të Komitetit “MKK” nga viset jugore të Shqipërisë si Sejfi Vllamasi, Bajram Fevziu, Eshref Frashëri etj., bënte pjesë edhe Rexhep Mitrovica, më pas edhe Sali Vuçiterni. Halim Gostivari e Ibrahim Gjakova²⁶. Rexhep Mitrovica, ishte edhe anëtar i kabinetit të Xhaferr Ypit (24.12.1921 deri 2.12.1922). Përkrah tyre llogariteshin Beshir Vokshi, ushtarakët Hadush Kastrati e Osman Tetova, në raste të caktuara edhe Bedri Pejani. Politikanë të tjerë nga Kosova u bënë anëtarë të Partisë Përparimtare të drejtuar fillimisht nga Hoxha Kadriu. Të grupuarit në këtë krah, Hasan Prishtina, Qerim Begolli, Xhemal Prishtina, Bajram Curri, Sali Gjuka etj., nuk i ndaheshin bindjes se Kosova mund të fitohej duke u mbështetur në politikën italiane, çka ndikoi në veprimtarinë e tyre politike dhe, në mjaft raste, i bashkoi ata në vitet 1920-1924, me italo-filët e Shqipërisë.

Ngjarjet e viteve 1920-1924 regjistrojnë pozicionime nga më të ndryshmet të emrave të njohur qysh më parë si anëtarë e bashkëpunëtorë të Komitetit të Kosovës.

²⁵ Kujtim Nuro, Nezir Bata, *Hasan Prishtina, Përmbledhje dokumentesh 1908-1934*, Tiranë: “8 Nëntori” 1983, dok. 66, f. 108-109.

²⁶ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 197, 310, 512; në *Historia e Popullit ...*, vëll. III, f. 179, kryetar i partisë shënohet Mehdi Frashëri e jo Hoxha Kadriu.

Pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve më 17 dhjetor 1920 dhe stabiliteti shtetëror, që rridhte nga ky anëtarësim, e shpejtuan integrimin e mërgatës politike kosovare në strukturat partiake e shtetërore të shtetit shqiptar. Jo rastësisht në zgjedhjet e para parlamentare, që më 21 prill 1921 nxorën 76 deputetë për të gjithë prefekturat e Shqipërisë, shumica e deputetëve kosovarë e nga viset e tjera matanë kufirit tashmë të integruar në jetën politike në Shqipëri, u votuan në prefekturën e Drinit (Dibrës) ku Partia Përparimtare kishte avantazh. Këtu dolën deputetë Hoxha Kadriu, Hasan Prishtina, Avni Gjilani, Irfan Ohri, Gani Strazimiri, Ramiz Daci, Rexhep Mitrovica, të cilëve më pas, më 22 dhjetor 1921 përveç R. Mitrovicës, që me riorganizimin e prefekturave ishte deputet i prefekturës së Kosovës (Kukësit), iu hoq mandati. Edhe pse gjatë diskutimeve në parlament, qeveria mbrojti pikëpamjen se aty duheshin bërë zgjedhje të reja, tani që ishin larguar trupat jugosllave të pushtimit (10 dhjetor 1921) ajo synonte të largonte nga Këshilli Kombëtar personat e përzier në krizën e 6-12 dhjetorit 1921, që konsideroheshin përgatitës të grushtit të shtetit. Me riorganizimin e prefekturave në vitin 1922, kur nga prefektura e Drinit u krijua prefektura e Kosovës dhe ajo e Dibrës, vendet e deputetëve të këtyre prefekturave në Parlament u kapën nga përkrahësit e pozitës, kryesisht anëtarë të Partisë Popullore, ndër të cilët bënte pjesë edhe i besuari personal i A. Zogut, Sali Vuçiterni e gjithashtu Bedri Pejani, Halim Gostivari, Ibrahim Gjakova dhe më vonë edhe Qamil Bala, që ishin përgjithësisht në linjën e partisë në pushtet²⁷. Largimi i rrezikut emergjent për Shqipërinë natyrshëm e thërrmoi edhe unitetin e përgjithshëm të imponuar nga kriza e viteve 1918-1920, si për elitën politiko-shoqërore të orientimit kombëtar, ashtu edhe për mërgatën politike të Kosovës të integruar në jetën e vendit në Shqipëri. Edhe një herë në skenën politike të vendit dolën sheshit problemet që bartte në vetvete përbërja e klasës politike, ku përziheshin patriotë, nacionalistë lokalë, intelektualë me formim dhe mendësi të ndryshme, idealistë që nuk njihnin mirë mentalitetin shqiptar, të tjerë që nuk kishin formimin e nevojshëm për të analizuar drejt koniunkturat rajonale e ndërkombëtare, apo edhe individë të prirur për të vënë në jetë interesa e ambicie personale.

²⁷ Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar, 1912-2005*, Tiranë: "55", 2006, f. 128, 152; S. Vllamasi, *Ballafaqimet politike...*, f. 506.

Homogjenizimi tërësor i Komitetit pas vitit 1920 vetëm me përfaqësues me origjinë nga Kosova e Dibra nuk çoi në ndonjë forcim të veprimtarisë së Komitetit. Çështja e Kosovës në kancelaritë dhe forumet ndërkombëtare ishte arkivuar kështu që përfaqësuesit nga viset e mbetura jashtë Shqipërisë, brenda ose jashtë Parlamentit të Tiranës, të pozicionuar në grupimet apo partitë e ndryshme politike të vendit, objektivisht nuk kishin kushte për të bërë më tepër se ngritjen e çështjes në kuadër të Konventës për Minoritetet dhe shpesh në funksion të politikës së partisë ku bënin pjesë e të luftës për elektorat.

Ndërkohë që pozita e drejtuar në fakt nga A.Zogu, vlerësonte se ndaj Jugosllavisë duhej ndjekur një politikë e “butë”, në të mirë të konsolidimit të Shqipërisë, grupimi opozitar gjente rast për të kritikuar se duhej punuar për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve jashtë Shqipërisë. Në këtë kuadër H. Prishtina gjatë vitit 1921 ngriti në Këshillin Kombëtar çështjen e mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve në Kosovë, Çamëri, madje në Turqi, Rumani etj.²⁸, si edhe nevojën e reagimit të fortë të Parlamentit dhe qeverisë shqiptare në arenën ndërkombëtare që të ndalej dhuna ndaj shqiptarëve në Kosovë etj.²⁹ Nuk munguan edhe kritika të forta të tij në drejtim të pozitës, për punë të pamjaftueshme diplomatike për çështjet kufitare të pazgjidhura, që i vlerësonte si arsye të rektifikimeve të reja kufitare në dëm të Shqipërisë në trevat e Gjakovës, Prizrenit e Dibrës³⁰. Ndërkohë Bedri Pejani, në Kongresin Ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve të mbledhur në Gjenevë më 1-10 shtator 1921, paraqiti një promemorie brilante si përfaqësues i “Komiteteve të Bashkuara të Shqiptarëve Irredentistë”. Promemoria, që trajtonte çështjen e shqiptarëve në Kosovë, Çamëri dhe në viset e tjera shqiptare të aneksuara nga fqinjët, në këtë veprimtari me sa duket të organizuar nën kujdesin e Italisë, i parapriu deklaratës së Fan Nolit në Gjenevë, të 2 tetorit 1921, ku ai, si përfaqësues i Shqipërisë, referoi për respektimin e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri³¹. Është vështirë të thuhet sa prononcimet e sipërpërmendura ishin një garë midis pozitës e opozitës për elektorat apo akordim i tyre në të mirë të bashkatdhetarëve në robëri. Ajo që mund të thuhet me siguri është se në morinë e

²⁸ K. Nuro, N. Bata, *Hasan Prishtina...*, f. 110. Diskutimi i H. Prishtinës në Këshillin Kombëtar, dt. 14 maj 1921.

²⁹ *Po aty*, f. 111-112.

³⁰ *Po aty*, f. 114-115.

³¹ *AQSH*, F. MPJ, V. 1921, D. 191, dok. 2-7.

problemeve dhe brenda potencialit politik që kishte Shqipëria në arenën ndërkombëtare, çështja e situatës së shqiptarëve në Jugosllavi e Greqi, nuk ishte jashtë vëmendjes së autoriteteve të Tiranës dhe anëtarët e Komitetit “MKK” të inkuadruar në radhët e pozitës apo opozitës parlamentare në Shqipëri, luajtën një rol të dallueshëm.

Në ngjarjet e vitit 1921, që kishin ngjyrën e një grushti shteti në përpjekje për të marrë pushtetin një pjesë e grupimit të qendrës të viteve 1918-1920 në Komitetin e Kosovës dhe grupimit të radikalëve si Hoxha Kadriu, Hasan Prishtina, Ramiz Daci, Irfan Ohri, Gani Strazimiri etj., u gjendën pikërisht në radhët e opozitës parlamentare të kohës. Qeveria 7 ditëshe e konturuar në dhjetorin e vitit 1921 nga Hasan Prishtina është dëshmia jo e vetme për këtë afrim. Pas dorëheqjes së Hasan Prishtinës më 1 dhjetor 1921, që pati në përbërje Hoxha Kadriun dhe Zija Dibrën, bashkëveprimet e dy grupimeve të sipërpërmendura do të vijonin edhe në gjithë periudhën pasuese të viteve 1922-1924, të karakterizuar nga organizime kryengritjesh, atentatesh etj., madje aty do të vihej re edhe ndonjë afrim nga radhët e të moderuarve që përgjithësisht kishin qenë pjesë e grupimit të pozitës. Por ndërkohë në krahun e kundërt u pozicionuan me forcë Ibrahim Gjakova, Sali Vuçiterni etj. Madje, sipas ndonjë të dhëne, grushtin e shtetit që rrëzoi qeverinë e Pandeli Evangjelit nuk e miratoi as Bajram Curri³².

Gjithsesi, në mars të vitit 1922, ai do të ishte protagonist i përpjekjeve për përmbysjen me armë të qeverisë³³.

Qysh në dhjetorin e vitit 1921, në dt. 21 dhjetor, dhjetë ditë pas dorëheqjes nga posti i kryeministrit, Hasan Prishtina, Hoxhë Kadriu dhe të tjerë e ftonin Elez Isufin të bashkëpunonte me Bajram Currin dhe të vinte me forcat e tij të armatosura në Tiranë që t'i bëhej presion parlamentit të ndalte revanshin e A.Zogut³⁴. Ndërkohë në qeverinë pasuese të Xhaferr Ypit, Rexhep Mitrovica do të përshihej si ministër i Arsimit, kurse Ramiz Daci do të shkonte në Dibër për të propaganduar e

³² S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 275; *Historia e Popullit ...*, vëll.III, f. 184; K.Dervishi, *Historia...*, f.160.

³³ K. Nuro, N. Bata, *Hasan Prishtina...*, f. 121-122.

³⁴ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 278, 279; *Historia e Popullit ...*, vëll.III, f. 185.

nxitur mosbindje kundër kësaj qeverie, çka i kushtoi kokën, sepse u kap e u pushkatua³⁵.

Marsi i vitit 1922 nxori përsëri në sipërfaqe qëndrimet e ndryshme në mërgatën politike kosovare të integruar plotësisht në jetën politike të Shqipërisë. Ndër drejtuesit për përgatitjen e një kryengritjeje kundër qeverisë Ypi u angazhuan Hasan Prishtina, Bajram Curri, Elez Isufi, Zija Dibra dhe mjaft figura me emër nga paria dibrane, ndërkohë që Ibrahim Gjakova aso kohe qarkkomandant i xhandarmërisë në Kukës, e këshillonte B. Currin që të mos rebelohej. Pas shtypjes së kryengritjes B. Curri e H. Prishtina mbetën në arrati. E. Isufi u tërhoq në Dibër, kurse Zija Dibra u largua në Itali³⁶.

Periodha në vijim e vitit 1922 u karakterizua nga ndryshime të shumta në aspektin politik në Shqipëri, veçanërisht në Partinë Popullore prej nga u larguan F. Noli, S. Delvina, deputetët e Gjirokastrës etj. Gjithsesi kjo parti vijoi të kishte shumicën në Parlament dhe A. Zogu në rrugën e forcimit të pozitive të tij bëri përfundimisht krah Salih Vuçiternën dhe ushtarakët Ibrahim Gjakovën, Sadush Kastratin, Osman Tetovën, Hamit Gjylbegun etj. Në krah të tij ishte edhe Bedri Pejani, i cili në këtë kohë lakmonte postin e ministrit të brendshëm, duke tërhequr pas vetes në kombinacionet politike edhe deputetët Halim Gostivarin, Qamil Balën etj.

Në këtë mënyrë në vitin 1922 Komiteti i Kosovës po bëhej gjithnjë e më fiktiv, kurse personalitetet e tij më të njohur Hoxha Kadriu, Bedri Pejani, Rexhep Mitrovica, Salih Vuçiterni, Qamil Bala, Halim Gostivari, Ali Shefqet Shkupi, Osman Tetova dhe shumë të afërt me ta, Aqif pashë Elbasani, Sejfi Vllamasi, Eshref Frashëri, Bajram Fevziu etj., ishin përfshirë në konfrontimet e grupazhet që karakterizonin jetën politike në Shqipërinë e asaj kohe duke u pozicionuar shpesh në krah të kundërt. Madje acarimi çoi në këtë kohë deri në qëndrime ekstreme antagoniste, që u shtuan veçanërisht pas vrasjes së Beshir Vokshit, ish anëtar i KMKK, si rezultat i përplasjeve midis radikalëve dhe të moderuarve brenda lëvizjes në Kosovë dhe njëherësh të paraqitjes si përkrahës të opozitës dhe pozitës brenda rrymave politike në Shqipëri. Mbizotërimi i rrymës radikale në këtë kohë vinte nga arsye objektive, që lidheshin me

³⁵ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 293; K. Dervishi, *Historia ...*, f. 165, 166.

³⁶ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 312.

situatën e rëndë në Kosovë dhe politikën e “butë” të pozitës në Shqipëri ndaj shteteve fqinje, e cila vlerësonte të domosdoshme për konsolidimin e shtetit shqiptar normalizimin e marrëdhënieve me fqinjët. Gjithashtu lidhej edhe me politikën e fortë të pozitës brenda në Shqipëri ndaj kundërshtarëve të saj. Këta për arsye konceptimi ose nën nxitjen e Romës qëndronin nën idenë se duhej sakrifikuar shumëçka për të fituar Kosovën, sado iracional që ishte ky qëndrim për momentin. Fiktiviteti i Komitetit “MKK” gjatë vitit 1922 u diktua ndër të tjera edhe nga arratisja e shumë anëtarëve me peshë të tij në krizën politike të dhjetorit 1921 dhe në grushtin e shtetit të marsit 1922. Ndër këta bënte pjesë edhe kryetari i Komitetit Hoxha Kadriu, i cili emigroi më 7 prill 1922 (fillimisht në Trieste e më pas në Vjenë) dhe vetëm në fund të gushtit 1923 u kthye përsëri në Shqipëri³⁷.

Pa u ndalur në ngjarjet e tjera të viteve 1922-1923, përmendim se në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese u dëshmuar përfundimisht pozicionimet e ndryshme të ish anëtarëve e veprimtarëve të Komitetit “MKK”. Ndër 102 anëtarët e Kuvendit Kushtetues të mbledhur më 21.01.1924 nga mërgata politike kosovare në Shqipëri dhe bashkëpunëtorët e KMKK, që figuronin përkrah grupimit të A. Zogut në pozitë, arritën të mandatohen: Sali Vuçiterni (fitoi në prefekturën e Dibrës), Eshref Frashëri (në prefekturën e Korçës), Sejfi Vllamasi (në prefekturën e Korçës) etj., kurse nga krahu i opozitës Hoxha Kadriu, Niman Ferizi, Dervish Mitrovica, Dr. Fahri Gjilani (në prefekturën e Kosovës). Në këtë prefekturë dështoi Rexhep Mitrovica, në Korçë dështoi Aqif pashë Elbasani, etj.³⁸

Në zgjedhjet e Kuvendit Kushtetues të 21 janarit 1924 bie në sy se Zogu dhe pozita ishin forcuar në Dibër por nuk kontrollonin ende prefekturën e Kosovës. Bie në sy gjithashtu pozicionimi në krahun e opozitës i shumicës së anëtarëve të Komitetit MKK, përkatësisht i shumicës së atyre që kishin bërë pjesë në radikalët dhe grupin e qendrës. Qëndrimet e fillimvitit 1924 do të përsëriteshin dhe në ngjarje të tjera të vitit 1924, përfshi edhe përmbysjet politike të qershorit dhe dhjetorit 1924, që përcaktuan largimin dhe rikthimin e A. Zogut në krye të pushtetit në Shqipëri. Duke pasur parasysh biografinë e mëvonshme politike të shumë personaliteteve të njohura politike të Komitetit të

³⁷ *Po aty*, f. 329.

³⁸ *Po aty*, f. 390.

Kosovës të viteve 1918-1924, që jetuan në vitet 1925-1939* si edhe raportet e tyre me Tiranën zyrtare të kohës të drejtuar nga A. Zogu, qofshin këta ndër miqtë e bashkëpunëtorët, apo armiqtë e kundërshtarët e A.Zogut, mund të konkludohet se është abuzim, ose i pa argumentuar, vlerësimi i paradokohshëm në historiografinë shqiptare se Komiteti i Kosovës u shkatërrua nga A.Zogu për shkak të detyrimit që ai i kishte Jugosllavisë për ndihmën e dhënë në vitin 1924 për t'u rikthyer në pushtet. Kundërshtarët politikë, kosovarë ose jo, A.Zogu i likuidoi politikisht disa edhe fizikisht, pikërisht si kundërshtarë që pengonin konsolidimin e pushtetit të tij. Hasan Prishtina, Zija Dibra, Rexhep Mitrovica etj., u likuiduan ose mbetën jashtë Shqipërisë, por anëtarë të Komitetit të Kosovës si Sali Vuçiterni, Bedri Pejani, Tafil Boletini, Ibrahim Gjakova etj., apo bashkëpunëtorë si Ali Shefqet Shkupi, Ali Riza Kosova, Mehmet Delia, Asim Vokshi, Xhemal Kadia, Ramiz Varvarica patën detyra të rëndësishme në administratën shqiptare të viteve 1925-1939, ose u lejuan të kthehen në Shqipëri³⁹. Madje regjimi i Tiranës, për sa kishte mundësi u përpoq ta mbante gjallë frymën kombëtare në Kosovë e Çamëri dhe të tërhiqte vëmendjen e opinionit politik e publik ndërkombëtar për të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi e Greqi. Në këtë kuadër pas kapërcimit të orientimeve të majta të Komitetit të Kosovës në emigracion në vitet 1925-1930, të drejtuar nga Bedri Pejani, Qamil Bala, Ibrahim Gjakova, u përkrah riorganizimi dhe gjallërimi i veprimtarisë së Komitetit në akord me Tiranën zyrtare⁴⁰.

Bashkëpunimi gjeti pasqyrim në kthimin në Shqipëri në vitin 1930 të Bedri Pejani dhe Ibrahim Gjakovës në botimin në Konstancë të Rumanisë të gazetës “Kosova” në maj 1932 - qershor 1933⁴¹. Pas distancimit përfundimtar të Bedri Pejani nga A. Zogu dhe pjesëmarrjes së tij në Kryengritjen e Fierit të vitit 1935, Komiteti i Kosovës mendohet të jetë riorganizuar në vitin 1936 në Vlorë nën drejtimin e Sali Vuçiternit

* Në vitin 1925 Hoxha Kadri Prishtina e Hysni Curri kishin vdekur, kurse Bajram Curri ishte vrarë.

³⁹ T. Boletini, *Kujtime...*; Preng Uli, *Asim Vokshi*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1978; Vangjel Kasapi, *Ali Riza Kosova*, Shkodër: Camaj-Pissa, 1996.

⁴⁰ *AQSH*, F. 251, V. 1933, D. 227, fl.2. Shih më gjerësisht Fatmira Rama, “Komiteti i Kosovës në bashkëpunim me organizatat e tjera politike (1925-1939)”, në vëll. *Komiteti i Kosovës*, f. 129-149.

⁴¹ *Po aty*.

dhe njëherësh kishte sinjale për aktivizim të një organizimi të ngjashëm të pavarur ose në formë dege, edhe në Kosovë⁴².

Orientimet e ndryshme kishin krijuar e do të krijonin gjithnjë diferenca në elitën politike kombëtare shqiptare. Elementët e evidentuar për veprimtari antikombëtare do të skartoheshin në çdo kohë nga “krahu kombëtar”, që do të kërkonte përmes individëve dhe grupeve apo partive rrugët dhe mjetet më të mira për realizimin e synimeve kombëtare, qoftë edhe përmes përplasjeve të dhimbshme të veprimeve joracionale. Nga kjo elitë me problemet, të metat, apo meritat e saj, nuk bënte përjashtim as elita politike e mërgatës kosovare e grupuar në “Komitetin e Kosovës”.

Orientimi i ndryshëm i anëtarëve të Komitetit të Kosovës në mërgim në vende të ndryshme të Europës, në një farë mënyre ishte vijim i orientimeve të ndryshme nga periudha e mëparshme. Gjithsesi koha tregoi se qoftë ata që u orientuan majtas, qoftë ata që u prirën drejt Italisë, qoftë ata që i ndërruan disa herë orientimet, nuk synuan veçse realizimin e ëndrrës së tyre për ta parë Kosovën të lirë e të bashkuar me Shqipërinë.

Kontributi i Komitetit “MKK” në vitet 1918-1924, por edhe më pas, ka qenë shumë i rëndësishëm për çështjen e Kosovës. Në saje të përpjekjeve të elitës politike kosovare të grupuar në këtë organizatë atdhetare u bë një punë e madhe për prezantimin e çështjes kombëtare në arenën ndërkombëtare, për të mbajtur gjallë frymën e qëndresës në Kosovë dhe për të ngritur në një nivel më të lartë interesimin dhe përpjekjet e shtetit shqiptar në të mirë të zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Një pjesë e ëndrrës së atdhetarëve të Komitetit “MKK” do të realizohej më 17 shkurt 2008.

⁴² *Po aty*; Hakif Bajrami, Bedri Pejani, *Një jetë dhe një vdekje për Shqipërinë etnike (1885-1946)*, Prishtinë 1994, f. 114. B. Pejani për pjesëmarrje në Kryengritjen e Fierit u arrestua dhe më 1937 emigroi përsëri në Francë për t'u rikthyer në Shqipëri më 1940.